



Prishtinë, 31 mars 2022
Kodi i ZRRE-së: V_1501_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, paragrafi 3 dhe 4, Nenit 25, Nenit 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2, dhe Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 3 paragrafi 1 nënparagrafet 51 dhe 72, Nenit 5, Nenit 33 paragrafi 4 nënparagrafi 4.1, Nenit 37, Nenit 38 dhe Nenit 62 paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Rregullës Nr. 15/2017 për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal (FSHU);
- Dispozitat e Nenit 17 të Licencës për Furnizim me energji elektrike lëshuar ndërmarrjes "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" (KESCO) J.S.C, me numër licence ZRRE/Tr_2014/Li_07/17, e datës 27.04.2017;
- Raportit përcjallës lidhur me vlerësimin e Konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për vitet 2018 dhe 2019 dhe matjet e indeksit Herfindahl-Hirschman (HHI) për vitin 2020, të shtator 2021;
- Raportin e ZRRE lidhur për Vlerësimin e Konkurrencës së tregut të energjisë për vitet 2020 dhe 2021, i datës 31.03.2022;

në seancën e mbajtur më 31 mars 2022 nxori këtë:

V E N D I M PËR VENDOSJEN E OBLIGIMIT TË SHËRBIMIT PUBLIK

- I. I Vendoset të Licencuarit për Furnizim me energji elektrike "KOSOVO ELECTRICITY SUPPLY COMPANY" J.S.C (në tekstin në vijim "KESCO"), obligimi i shërbimit publik për furnizim të konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal.
- II. Të drejtën e furnizimit si shërbim universal e gëzojnë:
 - a. të gjithë konsumatorët familjar;
 - b. Konsumatorët jo-familjar që kanë qarkullim vjetor jo më shumë se dhjetë milion euro (10,000,000 €), ose jo më shumë se pesëdhjetë (50) punonjës;
- III. Pa marrë parasysh pikë II të Dispozitivit të këtij Vendimi, të gjithë konsumatorët fundor kanë të drejtë të furnizohen me energji elektrike në tregun konkurrues.
- IV. Rregullatori do të rregullojë çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve që gëzojnë të drejtën e furnizimit në kuadër të shërbimit universal, të cilat mbulojnë kostot e arsyeshme të furnizimit me energji elektrike.

- V. Niveli i kostove për furnizim me energji elektrike dhe i çmimeve do të rishikohen në baza vjetore, në pajtim me Rregullën për Vendosjen e të Hyrave të Furnizuesit me Shërbim Universal.
- VI. Furnizuesi i ngarkuar me Obligimin e Shërbimit Publik, sipas këtij Vendimi obligohet që të:
- furnizojë me energji elektrike si shërbim publik sipas kushteve të përcaktuara me këtë Vendim, me licencë, si dhe me legjislacionin tjetër në fuqi;
 - informojë konsumatorët (blerësit) për të drejtat e tyre dhe kushtet e furnizimit në kuadër të shërbimit universal;
 - furnizojë me energji elektrike të një cilësie të caktuar sipas Rregullës për Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit;
 - faturtojë energjinë elektrike të livruar në pajtim me çmimet e përcaktuara nga Rregullatori;
 - publikojë tarifatat në faqen e vet të internetit, së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para fillimit të aplikimit.
- VII. Ky Vendim do të jetë pjesë përbërëse e Licencës për Furnizim me energji elektrike të lëshuar "KESCO"-s.
- VIII. Obligimi i ngarkuar KESCO-s sipas këtij Vendimi caktohet për një periudhë prej një (1) viti dhe zbatohet nga data **01.04.2022** deri më datën **31.03.2023**.

ARSYETIM

- Si rezultat i mungesës së konkurrencës efektive dhe me qëllim të sigurisë së furnizimit të qëndrueshëm me energji elektrike si dhe mbrojtjes së konsumatorëve, Rregullatori me datë 27 prill 2017 (Vendimi V_916_2017) i ka vendos KESCO për periudhën 3 vjeçare, nga 01.04.2017 deri 31.03.2020, Obligime të Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal.
- Me Vendimin e datës 03 korrik 2020 (Vendimi 1268_2020), nga arsyet e njohura të asaj kohe e që lidheshin me Pandeminë COVID19, Obligimi i Shërbimit Publik i është vazhduar edhe për një (1) vit KESCO-s, duke mbuluar periudhën nga 01.04.2020 deri më 31.03.2021. Për këtë veprim është njoftuar edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.
- Në mungesë të kuorimit të Bordit të ZRRE-së për ta trajtuar këtë çështje, ZRRE përmes komunikimit zyrtar (e-maili i datës 31 mars 2021) ka njoftuar KESCO-n se obligimi i mbetet deri me kompletimin e Bordit të ZRRE-së.
- Me Vendimin nr. 1419_2021 të nxjerrë në mbledhjen e Bordit të datës 07.10.2021, i është vazhduar KESCO Obligimi i Shërbimit Publik si Furnizues me Shërbim Universal deri me datë 31.03.2022.
- Në 31 mars të vitit 2022 Rregullatori ka aprovuar dokumentin Vlerësimin e Konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për vitet 2020 dhe 2021. Vlerësimi bazohet në llogaritjen e indekseve të përqendrimit të tregut, të tilla si përqindja e tregut (MS), raporti i përqendrimit (CRn), Indeksi Herfindahl-Hirschman (HHI), Treguesi i Furnizuesit Kryesor (PSI) dhe Indeksi i Furnizimit Rezidual (RSI).

- Rezultatet nga dokumenti Vlerësimi i Konkurrencës në tregun e energjisë elektrike në Kosovë për vitet 2020 dhe 2021 (të cekur më lartë) tregojnë se për periudhën e vlerësimit dhe bazuar në treguesit e analizuar, tregu i energjisë elektrike me shumicë dhe pakicë ende vazhdon të ballafaqohet me mungesë konkurrence dhe përqendrim të lartë.
 - Andaj, duke pasur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi të cekur në hyrje të këtij Vendimi, Rregullatori i ka vendosur KESCO-s Obligimin e Shërbimit Publik për ofrimin e Furnizimit me energji elektrike si Shërbim Universal, si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- IX. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- X. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.


Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtar


Gani Buçaj, anëtar

Vendimi i dërgohet:
KESCO-s
KEDS-it
KOSTT-it dhe
SKE, dhe
Aktivit të Rregullatorit